

## Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licenoi bursën e parë shqiptare me kapital privat

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2017
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2017

### Zhvillime të tjera

- AMF, në takim me brokerat e licencuar në sigurime, thekson misionin e përbashkët për mbrojtjen e konsumatorit
- Takim i përbashkët i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoni (ISA)
- AMF, *workshop* me ekspertë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të tregut të fondeve të investimit
- Drejtues të AMF-së në takime pune me përfaqësues të shoqatave, instituteve kombëtare dhe rregullatore të tregjeve financiare në Itali si IVASS dhe CONSOB
- Seminar ndërkombëtar i Komisionit të Letrave me Vlerë, SHBA
- Drejtues të AMF-së takohen me përfaqësues të "Standard and Poor's"

### Edukimi i Konsumatorit

- Rregullimi i tregjeve financiare dhe mbikëqyrja e sigurimeve gjithëpërfshirëse

### Lajme Ndërkombëtare

- Slloveni
- Turqi
- Ukrainë

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licenoi bursën e parë shqiptare me kapital privat

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licenoi më datë 3 korrik 2017 shoqërinë "Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE" sh.a., (*Albanian Stock Exchange*) si bursa e parë shqiptare me kapital privat e licencuar në vend. Vendimi i Bordit të AMFsë erdhi pas vlerësimit në përputhshmëri me kërkesat e legjislacionit të të gjithë dokumentacionit lidhur me objektin e aktivitetit, kapitalin, organet drejtuese të shoqërisë, infrastrukturën dhe sistemet teknologjike të nevojshme për realizimin e aktivitetit të saj.

"Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE" sh.a. është një shoqëri aksionare, me tre aksionarë themelues: Banka Credins sh.a., me 42.5% të kapitalit, Banka Amerikane e Investimeve sh.a. me 42.5% të kapitalit dhe shoqëria AK Invest sh.a. me 15% të kapitalit. Kapitali i regjistruar i kësaj shoqërie do të jetë 50,000,000 lekë. Shoqëria "Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE" sh.a. do të ketë si aktivitet kryesor:

- Ushtrimin e veprimtarisë si bursë e titujve, për tregtimin e titujve dhe instrumenteve të tjerë financiarë;
- Realizimin e një platforme tregtimi shumëpalëshe;
- Edukimin, promovimin dhe dhënien e informacionit grupeve të interesuara lidhur me veprimtaritë e tregut të kapitalit, aktivitetin e emetuesve të titujve të listuar në bursën e titujve dhe aktivitetin e anëtarëve të bursës së titujve, etj.
- Shoqëria "Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE" sh.a. do të përdorë sistemin elektronik të quajtur "Quick Trade", sistem i cili përdoret edhe nga Bursa e Lubljanës në Slloveni, si edhe nga Bursat e Shkupit, Sarajevës, Banja Lukës dhe Malit të Zi. Ky sistem mund të kryejë deri në 100,000 transaksione në ditë.

Në vitin e parë të aktivitetit, transaksionet e Bursës do të përqendrohen vetëm në tregtimin e titujve të qeverisë.

Në tregun shqiptar, krijimi i një burse është aktivitet progresiv për ekonominë e vendit, një pikë takimi midis njësive ekonomike për të gjetur kapital dhe rritur biznesin e tyre, si edhe qeverisë për të gjetur financime për projekte zhvilluese dhe për pushtetin vendor.

Parë në këndvështrimin makroekonomik për Shqipërinë, krijimi i një burse titujsh paraqet tregues konkretë dhe të qartë për nivelin e pjekurisë që ka arritur tregu financiar shqiptar. Ai gjithashtu:

- Sjell mundësinë që kompanitë dhe qeveria të gjejnë financime afatgjata për projekte të cilat bankat mund të mos jenë në gjendje t'i financojnë;

—○○○—  
"Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE" sh.a. është një shoqëri aksionare, me tre aksionarë themelues: Banka Credins sh.a., me 42.5% të kapitalit, Banka Amerikane e Investimeve sh.a. me 42.5% të kapitalit dhe shoqëria AK Invest sh.a. me 15% të kapitalit.  
—○○○—

—○○○—  
Krijimi i bursës në Shqipëri do t'u japë mundësi investitorëve të vegjël të përfshihen në tregun e letrave me vlerë në mënyrë transparente. Kjo do të zvogëlojë tregtimin në platformat online, në disa raste edhe joprofesionale, të cilat mbartin njëkohësisht edhe rrezikshmëri më të lartë investimi për publikun.

—○○○—

- Bën të mundur që kompanitë me fitim të kenë mundësinë të rriten, duke nxjerrë në shitje aksionet e tyre, tek një numër i madh aksionarësh dhe duke i diversifikuar ato;
- Mundëson investitorët të investojnë me besim, transparencë të rritur në një treg të mirërregulluar.

Krijimi i bursës në Shqipëri do t'u japë mundësi investitorëve të vegjël të përfshihen në tregun e letrave me vlerë në mënyrë transparente. Kjo do të zvogëlojë tregtimin në platformat online, në disa raste edhe joprofesionale, të cilat mbartin njëkohësisht edhe rrezikshmëri më të lartë investimi për publikun.

Bursa do të jetë një mundësi e mirë për të tërhequr, në vitet në vazhdim, edhe kompani nga zona të tjera shqipfolëse, siç është tregu i Kosovës, duke shërbyer edhe si një platformë bashkuese për të gjithë investitorët shqiptarë.

Krijimi i saj do t'i japë mundësi edhe lidhjes së kësaj burse me projekte të filluara nga vende të tjera në rajon. Aktualisht, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, BERZH, ka iniciuar një projekt rajonal ku është e përfshirë bursa e Sllovenisë, Bullgarisë, Maqedonisë, Kroacisë e Serbisë dhe synon krijimin e një infrastrukture për tregtimin e letrave me vlerë në këto vende dhe për rritjen e bashkëpunimit mes tyre në këtë drejtim. Gjithashtu, BERZH ka investuar në këto bursa, duke blerë një pjesë të aksioneve. Integrimi në platformat e ngjashme rajonale do të jetë një shans më shumë për Shqipërinë për gjetjen e burimeve alternative të financimit.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2017

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-qershor 2017 kapën vlerën mbi 7.42 miliardë lekë, ose 12.03% më shumë se gjatë periudhës janar-qershor 2016. Gjatë periudhës janar-qershor 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 551,848 me një rritje prej 14.69% krahasuar me periudhën janar-qershor 2016.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 44.02% në krahasim me periudhën janar-qershor 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.55 miliardë lekë, apo 57.13% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 11.20% gjatë periudhës janar-qershor 2017, krahasuar kjo me periudhën janar-qershor 2016.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 4.32 miliardë lekë gjatë periudhës janar-qershor 2017, duke shënuar një rritje prej 11.43% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 58.54% të tregut të sigurimeve.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 13.71% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 11.43% të tregut të Jo-Jetës.


### Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 23.07% krahasuar me periudhën janar-qershor 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 65.20% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 4.32 miliardë lekë gjatë periudhës janar-qershor 2017.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-qershor 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



## Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2017


Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2017 u dominua në masën 67.88% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 32.12% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 93.68% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2017 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 59.86% dhe 30.20% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.62% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2017 u dominua në masën 67.88% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 32.12% ishin instrumente afatgjatë (obligacione).

## Letra me vlerë të Qeverisë, janar-qershor 2017



- A. Blerje në tregun primar**
- B. Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar**
- C. Blerje para afatit të maturimit**
- D. Vendosje e bonos si kolateral**
- E. Shlyerje e vlerës nominale në maturim**

### Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-qershor 2017, ka pasur një ulje prej 1,224 milionë lekë ose 33.36% krahasuar me periudhën janar-qershor 2016. Gjithashtu dhe numri i transaksioneve është ulur në masën 47.66%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-qershor 2017 ka pasur ulje prej 779 milionë lekë ose 38.61% dhe gjithashtu, një ulje në numrin e transaksioneve në masën 20.46%, krahasuar me periudhën janar-qershor 2016.

Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 2,003 milionë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 2,003 milionë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
	2016	2017	
<b>janar-qershor</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>'17/'16-1</b>
<i>Shitje nga portofoli i ndërmjetësit</i>			
<i>B financiar</i>	3,669.58	2,445.49	(33.36)
<b>Individë</b>	<b>3,020.23</b>	<b>2,201.13</b>	<b>(27.12)</b>
<i>Persona juridike</i>	649.35	244.35	(62.37)
<i>C Blerje para afatit të maturimit</i>			
<i>Individë</i>	1,535.34	1,221.31	(20.45)
<i>Persona juridike</i>	481.90	17.00	(96.47)



## ZHVILLIME TË TJERA

### AMF, në takim me brokerat e licencuar në sigurime, thekson misionin e përbashkët për mbrojtjen e konsumatorit

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi, zhvilloi më datë 19 korrik, një takim me brokerat e licencuar në sigurime. Qëllimi kryesor i takimit ishte forcimi i bashkëpunimit dhe komunikimit të mëtejshëm me shoqëritë e brokerimit dhe brokerat fizikë, për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë të interesave të konsumatorëve.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi dhe drejtues të lartë të AMF-së, gjatë takimit me brokerat e licencuar në sigurime*

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së Z. Koçi vlerësoi si mjaft të rëndësishëm veprimtarinë e brokerimit në sigurime, për t'i ofruar konsumatorit zgjedhjen e alternativës më të mirë.

Nga veprimtaria e brokerimit, gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, janë realizuar më shumë se 1.95 miliardë lekë prime të shkruara bruto, kryesisht të realizuara në sigurimin e detyrueshëm motorik. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së Z. Koçi vlerësoi si mjaft të rëndësishëm veprimtarinë e brokerimit në sigurime, për t'i ofruar konsumatorit zgjedhjen e alternativës më të mirë. Z. Koçi theksoi se AMF, në strukturën e re organizative, do të ketë një njësi të posaçme për monitorimin e brokerave, e cila do të realizojë edhe inspektimet on-site dhe off-site për të mbikëqyrur veprimtarinë e brokerimit, duke pasur në vëmendje praktikatat më të mira të vendeve të rajonit dhe të Evropës. Qëllim parësor i saj do të jetë mbrojtja sa më mirë e interesave të konsumatorëve. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv prezantoi synimin kryesor të AMF-së, për zgjerimin e pasurimit e tregut të sigurimeve me produkte sa më të përshtatshme për konsumatorin dhe punën që po bën AMF për hartimin e një strategjie afatgjatë për zgjerimin e tregjeve nën mbikëqyrje. Ai i ftoi shoqëritë e brokerimit për të dhënë kontributin e tyre për zhvillimin më tej të tregut të sigurimeve.

Gjatë takimit shoqëritë e brokerimit prezantuan problematikat dhe këndvështrimet e tyre në realizimin e punës së përditshme. Ata u shprehën të gatshëm për të rritur bashkëpunimin e mëtejshëm me Autoritetin, duke sjellë edhe propozime për ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, që do të ndikojë në funksionimin sa më të mirë të tregut dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Ndër propozimet përfshiheshin edhe:

- Klasifikimi i brokerave që veprojnë në treg, për kapacitetin dhe funksionimin e tyre, bazuar në raportimet periodike që ata sjellin në AMF;

- Plotësimi i akteve nënligjore në mënyrë që të vendoset përfaqësimi i brokerit në kontratën e sigurimit, duke e krijuar kështu mundësinë për një mbrojtje më të mirë të konsumatorit.

Veprimtaria e brokerimit në Shqipëri, deri tani, është e drejtuar kryesisht tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat zënë mbi 98% të veprimtarisë së tyre dhe një përqindje fare të vogël e zë brokerimi për sigurimin e Jetës. Në treg janë të licencuar dhe operojnë 34 broker fizikë dhe 15 shoqëri brokerimi, duke përfshirë edhe 3 banka.

## **Takim i përbashkët i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoni (ISA)**

Në datat 10–11 korrik 2017 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi takime të përbashkëta pune me drejtues të lartë të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA), të përfaqësuar nga Z. Klime Poposki, President i Këshillit të Ekspertëve, dhe Z. Zoran Stojanovski e Z. Lulzim Imeri, anëtarë ekzekutivë të Këshillit të Ekspertëve në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoni, ISA. Qëllimi i takimit ishte forcimi më tej i bashkëpunimit mes institucioneve, për një mbikëqyrje efektive dhe dinamike të tregut të sigurimeve në të dy vendet.

Qëllimi i takimit ishte forcimi më tej i bashkëpunimit mes institucioneve, për një mbikëqyrje efektive dhe dinamike të tregut të sigurimeve në të dy vendet.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi dhe drejtues të lartë të AMF-së, gjatë takimit me drejtues të lartë të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Maqedoni*

Gjatë takimit u paraqitën disa tregues të rezultateve të kompanive shqiptare të sigurimeve që veprojnë edhe në tregun e Maqedonisë, u diskutua lidhur me zhvillimet legjislative në të dyja vendet, me ecurinë e aktivitetit, rolin dhe përgjegjësitë e ndërmjetësve në sigurime që veprojnë në Shqipëri e në Maqedoni si edhe mbi mbikëqyrjen me bazë rreziku, me të cilën AMF po realizon inspektimet e saj në tregun e sigurimeve.

Në fjalën e tij të mirëseardhjes, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit midis dy rregullatorëve dhe më gjerë të mbikëqyrësve në rajon për tregun e sigurimeve. Z. Koçi theksoi se tregu i sigurimeve ka pasur zhvillime pozitive në Shqipëri në vitet e fundit. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi se autoritetet mbikëqyrëse në të dy vendet do të fillojnë të mendojnë më gjerë për



harmonizimin e mekanizmave për mbikëqyrjen e grupeve, në përputhje me Parimet Bazë të Mbikëqyrjes dhe praktikat ndërkombëtare, si edhe të kenë një kuptim të përbashkët mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare.

Z. Klime Poposki, President i Këshillit të Ekspertëve të ISA-s e konsideroi bashkëpunimin midis dy institucioneve si shumë të rëndësishëm për mbikëqyrjen në sigurime dhe kjo jo thjesht për shoqëritë e sigurimeve që veprojnë në të dy tregjet. Ai nënvizoi se AMF dhe ISA si autoritete rregullatore të të dy vendeve po përballen me të njëjtat sfida të mbikëqyrjes, kanë në përdorim të njëjtën platformë elektronike raportimi, kanë të përbashkët përpjekjen për zbatimin e direktivave të Bashkimit Evropian në procesin e integritimit si edhe po zbatojnë projektin e përbashkët për mbrojtjen nga katastrofat natyrore me mbështetjen e Bankës Botërore. Ai vlerësoi shumë bashkëpunimin me AMF nëpërmjet inspektimeve të përbashkëta të realizuara nga të dy autoritet mbikëqyrëse të Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Gjatë takimit u prezantua me shifra situata e dy tregjeve përkatëse dhe doli qartë potenciali që këto tregje mbartin për zhvillimet në të ardhmen. Në përfundim u ra dakord për hartimin e një plani të përbashkët pune për zhvillimin më tej të bashkëpunimit dypalësh. Të dy autoritetet kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit që prej viti 2010.

### **AMF, workshop me ekspertë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të tregut të fondeve të investimit**



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi dhe drejtues të lartë të AMF-së, gjatë workshop-it me ekspertë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të tregut të fondeve të investimit*

Në kuadër të fazës së dytë të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, në datën 5 korrik 2017 u zhvillua një workshop me përfaqësues të tregut të fondeve të investimit, ekspertë të fushës së tregut të kapitaleve, kompani emetuese të letrave me vlerë me ofertë private dhe palë të tjera të interesit.

Faza e dytë e projektit konsiston në përmirësimin e kuadrit mbikëqyrës dhe rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ të letrave me vlerë dhe fondeve të investimit në përputhje me parimet e BE-së dhe standartet ndërkombëtare.



Faza e dytë e projektit konsiston në përmirësimin e kuadrit mbikëqyrës dhe rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ të letrave me vlerë dhe fondeve të investimit në përputhje me parimet e BE-së dhe standartet ndërkombëtare.



Në fjalën e tij përshëndetëse, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi theksoi rëndësinë e zhvillimit të tregut të kapitaleve për investitorët, bizneset dhe rritjen ekonomike të vendit si dhe domosdoshmërinë për zhvillimin e tregut sekondar, në funksion të rritjes së likuiditetit apo vlerësimit të drejtë të portofolit të aseteve. Në fjalën e tij, Z. Koçi përmendi edhe sfidat e Autoritetit përballë dinamikës së zgjerimit të tregut të fondeve të investimit dhe tregut të letrave me vlerë si dhe faktin që ndryshimet ligjore në kuadër të këtij projekti do të jenë në linjë me direktivat e BE-së, sidomos me direktivën *MiFID II* apo direktiva të tjera.

“Ky *workshop* vjen pikërisht në momentin kur Bordi i AMF-së sapo mori një vendim të rëndësishëm në mbledhjen e fundit të tij në lidhje me fillimin e punës së një ndër elementëve thelbësorë të tregut të titujve siç është Bursa,” theksoi Z. Koçi në fjalën e tij. Në përfundim, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se AMF beson se në bashkëpunim me ekspertët e Projektit do të jetë i gatshëm për të rregulluar dhe mbikëqyrur tregun e kapitaleve, për të rritur sigurinë e sektorit financiar jo-bankar dhe për të kontribuar në stabilitetin financiar të vendit.

Më pas, Znj. Michelle Parnel, eksperte ligjore dhe Znj. Sally Buxton, konsulente e projektit prezantuan gjetjet dhe rekomandimet e tyre gjatë kësaj faze të dytë të projektit në lidhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të titujve dhe të fondeve të investimit. Direktivat Europiane, theksoi Znj. Parnell, do të kenë ndikim në legjislacionin vendas të letrave me vlerë dhe si vend kandidat për anëtarësimin në BE, lind domosdoshmëria e përafrimit të legjislacionit të titujve me direktivat e BE-së si dhe direktivën *MIFID*, direktivën e prospektit, direktivën mbi transparencën, por njëkohësisht ligjet dhe rregulloret e titujve duhet të jenë në përputhje edhe me parimet e IOSCO-s, pasi AMF është anëtare e kësaj organizate.

Znj. Buxton prezantoi edhe zhvillimet e ardhshme të AMF-së lidhur me kapacitetet e Autoritetit në përgjigje të zhvillimeve të tregjeve dhe rolin e tij në zhvillimin e tregjeve të kapitalit. Në përfundim të prezantimeve pjesëmarrësit u ftuan për sugjerime, komente dhe pyetje në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e ekspertëve.

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, i cili financohet nga Sekretariati Zvicerian për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe mbështetet nga Banka Botërore, ka filluar në korrik të vitit 2016 dhe ka një kohëzgjatje trevjeçare. Faza e parë e tij u përmbyll në nëntor të vitit 2016 dhe aktualisht po punohet për fazën e dytë dhe të tretë të tij.

○ ○ ○

Direktivat Europiane, do të kenë ndikim në legjislacionin vendas të letrave me vlerë dhe si vend kandidat për anëtarësimin në BE, lind domosdoshmëria e përafrimit të legjislacionit të titujve me direktivat e BE-së si dhe direktivën *MIFID*, direktivën e prospektit, direktivën mbi transparencën.

○ ○ ○

## Drejtues të AMF-së në takime pune me përfaqësues të shoqatave, instituteve kombëtare dhe rregullatore të tregjeve financiare në Itali si IVASS dhe CONSOB



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi dhe drejtues të lartë të AMF-së, gjatë takimit me përfaqësues të shoqatave, instituteve kombëtare dhe rregullatore të tregjeve financiare, Itali

Me ftesë të Institutit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Italisë, (*Instituto per la Vigilanza sulle Assicurazioni, IVASS*), Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së dhe drejtues të departamenteve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare morën pjesë në Konferencën me temë “Kërkimet në tregun e sigurimeve” (*Conference on Insurance Research*), në datat 13-14 korrik 2017, në Romë, Itali.

Në konferencë pati prezantime lidhur me përvojat më të mira në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, u shkëmbye informacion mbi bazën rregullative në tregun e sigurimeve, mbikëqyrjen me bazë rrisht dhe zbatimin e *Solvency II*, direktivë e cila solli një ndryshim shumë të madh në aspektin financiar, organizativ, ligjor dhe operacional në industrinë e sigurimeve si dhe për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit. Gjatë seancave të konferencës pati edhe prezantime lidhur me tema të tjera si:

- Pse mbikëqyrja dhe rregullimi në sigurime janë të rëndësishme për investimet afatgjata dhe rritjen ekonomike;
- Çështje specifike të marrjes në sigurim, parametrat e *Solvency II*;
- Modelet e ndryshme për menaxhimin e rrisht;
- Konkurenca dhe Shëndeti Financiar në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës;
- Pronësia dhe mirëqeverisja në industrinë e sigurimeve, etj.

Një nga tematikat më të rëndësishme të diskutuara në takim lidhej me sigurimin e detyrueshëm motorik dhe atë nga katastrofat natyrore. Mjaft nga prezantimet lidheshin me përvojat e ndryshme për këto dy grupe sigurimesh dhe studimet e zhvilluara nga universitete të ndryshme në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjatë ditëve të konferencës z. Ervin Koçi pati edhe takime në zyrat e Institutit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Italisë, me z. Riccardo Cesari anëtar i bordit të

Në konferencë pati prezantime lidhur me përvojat më të mira në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, u shkëmbye informacion mbi bazën rregullative në tregun e sigurimeve, mbikëqyrjen me bazë rrisht dhe zbatimin e *Solvency II*, direktivë e cila solli një ndryshim shumë të madh në aspektin financiar, organizativ, ligjor dhe operacional në industrinë e sigurimeve si dhe për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit.



Në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e Bashkimit Evropian për sigurimin motorik, këto takime ndihmuan në njohjen më të mirë të bazës rregullatore evropiane që do të shërbejë në hartimin e akteve nënligjore të përshtatshme me direktivat evropiane, sistemin e tarifimit dhe përcaktimin e procedurave për zgjidhjen e dëmeve sipas standardeve të BE-së.



drejtorëve. Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së pati takim të nivelit të lartë me zyrtarë të Komisionit Kombëtar për Shoqëritë dhe Bursën (*Commissione Nazionale per la Societa e la Borsa, CONSOB*). Në këto takime u diskutua mbi forcimin e marrëdhënieve midis rregullatorëve nëpërmjet asistencës teknike, trajnimeve si dhe nënshkrimit të marrëveshjeve dy palëshe.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e Bashkimit Evropian për sigurimin motorik, këto takime ndihmuan në njohjen më të mirë të bazës rregullatore evropiane që do të shërbejë në hartimin e akteve nënligjore të përshtatshme me direktivat evropiane, sistemin e tarifimit dhe përcaktimin e procedurave për zgjidhjen e dëmeve sipas standardeve të BE-së.

## **Seminar ndërkombëtar i Komisionit të Letrave me Vlerë, SHBA**

Instituti Ndërkombëtar Thomas A. Biolsi për Pajtueshmërinë dhe Inspektimet (2017 *Thomas A. Biolsi International Institute for Compliance and Examinations*) zhvilloi në datat 10-14 korrik 2017 një seminar ndërkombëtar për njohjen dhe shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet rregullatorëve mbikëqyrës në tregun e kapitaleve. Seminari u organizua pranë zyrave qendrore të Komisionit të Letrave me Vlerë të SHBA-ve (*Securities and Exchange Commission, US SEC*) në Washington, DC. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u prezantua në këtë aktivitetet nga Kryetari i Bordit të AMF-së, Z. Pajtim Melani.

Programi i seminarit u fokusua në disa tematika të lidhura me pajtueshmërinë dhe inspektimet e pjesëmarrësve në tregjet e kapitalit, duke përfshirë edhe brokerat, këshilluesit e investimeve, skemat e investimeve kolektive, organizatat vetërregulluese, si dhe agjencitë e vlerësimit.

Programi ishte ndërtuar edhe në formatin e prezantimeve, diskutimeve, rasteve studimore dhe punës në grup, si dhe diskutimeve aktive të drejtuara nga zyrtarë të lartë të SEC dhe organizata vetërregulluese. Ky program ofron mundësi të mirë për një punë të përbashkët në përpjekjet për zhvillimin e një sistemi të fortë rregullativ që nxit integritetin e tregjeve globale të letrave me vlerë.

Në takime të veçanta gjatë këtij aktiviteti, Kryetari i Bordit të AMF-së, Z. Melani, diskutoi me ekspertët e SEC mbi politikat e licencimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes, të domosdoshme për zhvillimin e tregut të kapitalit në Shqipëri. Në fokus të takimit ishte edhe hapja e bursës në Shqipëri, dhe shkëmbimi i eksperiencave në politikat e licencimit dhe rregullimit të bursave, si dhe risqet që shoqërojnë ato. Gjithashtu u shkëmbyen eksperiencia lidhur me përgjegjësitë që duhet të kenë ndërmjetësit financiarë, mbi rreziqet e tregtimit në platformat online, si dhe identifikimin e platformave të palicencuara.

Gjatë qëndrimit në Washington, Kryetari i Bordit të AMF-se, Z. Pajtim Melani, dha

një intervistë në TV "Zëri i Amerikës" mbi licencimin e bursës së parë private. Ndër të tjera gjatë intervistës u diskutua edhe mbi zhvillimet e fundit në tregjet nën mbikëqyrjen dhe rregullimin e AMF-së, zhvillimin e tregut të pensioneve private e zgjidhjet e problematikave, si dhe zhvillimin e tregut të sigurimeve të detyrueshme motorike.

Intervistën e plotë të Kryetarit të Bordit të AMF-se, Z. Pajtim Melani e lexoni në <https://www.zeriamerikes.com/a/3937721.html>

## **Drejtues të AMF-së takohen me përfaqësues të "Standard and Poor's"**

Znj. Kaçi prezantoi rolin e AMF-së si autoritet rregullator në tregun financiar jobankar, duke u përqendruar tek ecuria e tregjeve të mbikëqyrura dhe të rregulluara nga AMF gjatë periudhës një vjeçare.

Përfaqësues të kompanisë ndërkombëtare të vlerësimit "Standard & Poor's" zhvilluan më 12 korrik një takim me Nëndrejtoreshen Ekzekutive të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Mimoza Kaçi në kuadër të vizitës së tyre vjetore në vend.

Znj. Kaçi prezantoi rolin e AMF-së si autoritet rregullator në tregun financiar jobankar, duke u përqendruar tek ecuria e tregjeve të mbikëqyrura dhe të rregulluara nga AMF gjatë periudhës një vjeçare.

Në veçanti palët diskutuan mbi zhvillimet në tregun e titujve, ndryshimet në kuadrin rregullator për fondet e investimeve, licensimin e bursës së parë shqiptare me kapital privat dhe zhvillime të tjera. Në takim u theksuan masat e ndërmarra nga Autoriteti, me qëllim menaxhimin e mirë të risqeve, garantimin e interesave të investitorëve dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut.

Nga ana e tyre përfaqësuesit e "Standard & Poor's" shprehën vlerësime pozitive për qëndrueshmërinë e tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së.

## Rregullimi i tregjeve financiare dhe mbikëqyrja e sigurimeve gjithëpërfshirëse

Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS) ka publikuar një dokument mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve gjithëpërfshirëse të sigurimeve, ku synohet gjetja e mjeteve për përfshirjen në skemat e sigurimeve të shtresave të marginalizuara dhe atyre me të ardhura nën mesataren. Dokumenti shërben si një udhërrëfyes në zbatimin e skemave gjithëpërfshirëse të sigurimeve.

(Marrë me shkurtime e redaktime)

Përfshirja financiare” i referohet një gjendjeje ku të gjithë personat në moshë pune kanë akses efikas në produktet financiare (kreditë, kursimet, pagesat dhe sigurimet nga ofruesit formalë). "Akses efikas" nënkupton ofrimin e shërbimeve të përshtatshme dhe të përgjegjshme, me një kosto të përballueshme për konsumatorin dhe të qëndrueshme për ofruesin, me kushtin që konsumatorët e përjashtuar financiarisht të mund të përdorin shërbime formale financiare në vendin e opsioneve joformale ekzistente.

Tregjet e sigurimeve gjithëpërfshirëse, si një element kontributiv në përfshirjen financiare, karakterizohen nga:

- Përballueshmëria;
- Qëndrueshmëria;
- Përshtatshmëria;
- Përgjegjësia; dhe
- Ofrimi nga siguruesit dhe ndërmjetësit e licencuar dhe të mbikëqyruar të të gjithë pjesëve të produktit dhe shërbimit të sigurimit.

Përfshirja financiare jep kontribut në stabilitetin financiar. Ajo përbën një element të rëndësishëm në sigurimin e tregjeve financiare nën juridiksion, të drejta, të sigurta dhe të qëndrueshme. Përfshirja efektive e pjeshme mund të ketë ndikuar dhe ka sjellë paqëndrueshmërinë e sektorit financiar. Lidhja midis përfshirjes financiare dhe stabilitetit financiar është një ndër arsytet për interesin e shfaqur nga liderët e G20 në lidhje me këtë çështje.

Parimet për Përfshirjen Novatore Financiare (Parimet), të mbështetura nga liderët e G20 në vitin 2010, ndihmojnë në krijimin e një politike dhe mjedisi rregullator për përfshirjen financiare novatore. Përfshirja financiare novatore ka të bëjë me përmirësimin e aksesit në shërbimet financiare për qytetarët me të ardhura të ulëta nëpërmjet përhapjes së sigurtë dhe të shëndoshë të qasjeve të reja. Parimet pasqyrojnë kushtet e favorshme për nxitjen e inovacionit gjatë përfshirjes financiare, duke mbrojtur stabilitetin financiar dhe konsumatorët. Ato mund të përshtaten në kontekste të ndryshme të vendit.

Përfshirja financiare” i referohet një gjendjeje ku të gjithë personat në moshë pune kanë akses efikas në produktet financiare (kreditë, kursimet, pagesat dhe sigurimet nga ofruesit formalë).



## Barrierat e tregjeve të sigurimeve gjithëpërfshirëse

Tregjet e sigurimeve pjesërisht gjithëpërfshirëse mund të pasqyrojnë një ose më shumë “barriera” aksesit. Barrierat mund të ekzistojnë në shumë forma dhe nuk kufizohen vetëm tek çështja e kostos së produkteve dhe shërbimeve. Ato mund të përfshijnë përballueshmërinë, gjeografinë, kulturën, administrimin, logjistikën, gjuhën dhe edukimin. Barrierat e aksesit mund të lidhen me blerjen e produktit, pagesat e vazhdueshme të primeve dhe shërbimet e grumbullimit, dëmet ose trajtimin e ankesave të shërbimit të klientit. Barrierat mund të ndikojnë tek konsumatorët (ana e kërkesës), tek ofruesit (ana e ofertës), ose tek të dyja bashkë. Barrierat nga ana e kërkesës mund të lindin pasi konsumatorët zakonisht kanë të ardhura të ulëta dhe/ose vlera të ulëta neto, edhe pse ky segment nuk është detyrimisht i varfër në mënyrë uniforme. Ata mund të jenë shpesh të vetëpunësuar dhe të përjashtuar nga mbulimi i skemave të mbrojtjes sociale të shtetit për sektorin ku aplikohet. Modelet e të ardhurave, kursimeve dhe shpenzimeve janë të ndryshme nga segmentet me të ardhura më të larta. Të ardhurat janë shpesh sezonale dhe janë subjekt i luhatjeve. Të ardhurat e disponueshme janë të vogla. Pjesa më e madhe e të ardhurave të tyre shpenzohen për kërkesat themelore siç janë ushqimi dhe strehimi. Prandaj, nivelet e përballueshmërisë janë të ulëta. Aftësia e tyre për të kuptuar zotimet financiare ose zbutja e riskut në faza të ndryshme të jetës mund të jetë e dobët.

Për vite me rradhë, performanca e sigurimeve për qytetarët me të ardhura të ulëta ka qenë shumë e dobët. Siguruesit konvencionalë janë përqendruar tek të ardhurat më të larta dhe në segmentet e korporatave si biznesi i tyre kryesor. Prandaj, janë krijuar me këtë fokus modelet e tyre të biznesit, duke përfshirë këtu produktet, strukturat e kostos, praninë gjeografike, rrjetet e shpërndarjes dhe infrastrukturën e shërbimit. Siguruesit kanë patur si tendencë të mos i konsiderojnë atraktivë segmentet me të ardhura të ulëta për shkak të arsyeve të ndryshme:

- Përmasat e primeve individuale u perceptuan si tepër të ulëta për kostot fikse sipas politikës;
- Llogaritja e primit shihej si më e ndërlikuar për shkak të të dhënave të kufizuara të disponueshme;
- Dhe natyra e kërkesës e rreziqet e këtij segmenti ishin të panjohura.

Rrjeti i shpërndarjes, i cili ishte më praktik dhe më familjar me segmentet e të ardhurave të mesme ose të larta, nuk e shikonte si fitimprurëse marrëdhënien e biznesit me personat me të ardhura të ulëta, pasi strukturat tradicionale të shpërbllimit ofrojnë iniciativë për t'u përqendruar në produkte me prime më të mëdha. Rregullimi proporcional mund të zvogëlojë barrierat.

Është e nevojshme të kapërcehen barrierat për t'i bërë tregjet ekzistuese më gjithëpërfshirëse. Zgjidhja nuk bazohet thjesht në ofrimin e politikave me primet më të vogla, me përjashtim të rasteve kur kosto është barriera e vetme. Qasjet gjithëpërfshirëse zakonisht përfshijnë risi në projektimin e produktit, mbulimin dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe përmasat e produktit. Si rrjedhojë, ajo që konsiderohet shpesh si “sigurimi mikro”, trajtohet në këtë dokument por konceptet shkojnë përtej “sigurimit mikro” si një produkt i veçantë adresuar tregjeve të sigurimeve gjithëpërfshirëse.

Barrierat nga ana e kërkesës mund të lindin pasi konsumatorët zakonisht kanë të ardhura të ulëta dhe/ose vlera të ulëta neto, edhe pse ky segment nuk është detyrimisht i varfër në mënyrë uniforme.

## Sloveni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në tremujorin e parë të vitit 2017, siguruesit slovenë arritën një volum të primeve të shkruara bruto prej 607.4 milionë euro, me një rritje prej 6.6% në terma vjetorë. Në tregun e sigurimeve të Jetës volumi i primeve të shkruara bruto arriti 167.7 milionë euro, me rritje vjetore 13.7%, ndërsa sigurimet e Jo-Jetës raportuan 439.7 milionë euro, me rritje 4.2% në terma vjetore.

Në tregun e sigurimit të Jetës, dy ishin grupet kryesore që raportuan rritje pozitive: Produktet e lidhura me skemat e investimeve, të cilat u rritën me 12.5% që arritën në 82.7 milionë euro dhe policat tradicionale të sigurimit të Jetës të cilat u rritën me 12.9% në terma vjetore duke arritur në 72.6 milionë euro.

## Turqi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave paraprake të publikuara nga shoqata lokale e siguruesve (*Insurance Association of Turkey, TSB*) volumi total i primeve të shkruara bruto i tregut turk të sigurimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, arriti në rreth 12.4 miliardë TRY (Lira Turke, monedha lokale) ose rreth 3.2 miliardë euro. Rritja ishte rreth 15.7% krahasuar me vitin e kaluar.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës arriti në 10.8 miliardë Lira Turke në terma të primeve të shkruara bruto, me një rritje prej 86.7%. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës gjeneroi 1.7 miliardë Lira.

Sipas të dhënave nga Komisioni Shtetëror i Ukrainës për Rregullimin e Shërbimeve Financiare (*Ukrainian State Commission for Regulation of Financial Services*) gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, volumi i primeve të shkruara bruto nga siguruesit vendas u rrit me 31.69% në terma vjetorë, duke arritur në 10,895.90 milionë UAH (monedha lokale Ukrainian Hryvnia) ose rreth 367.62 milionë euro. Tregu i sigurimit të Jetës kishte një rënie prej 4.31%, ndërsa sigurimi i Jo-Jetës pati rritje prej 34.82%.

Sipas të dhënave të publikuara nga ky komision, siguruesit e tregut të sigurimeve të paguan dëmshpërblime në masën e 129 milionë UAH, ose rreth 4.257 milionë euro, me një rritje prej 21% më shumë krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2016.

Edhe gjatë vitit 2017 vazhdoi tendenca e përqendrimit të tregut. Kështu, në fillim të vitit 2016 në treg ishin aktivë 306 sigurues të Jo-Jetës dhe 46 kompani të sigurimit të Jetës, ndërsa në vitin 2017 numri i tyre u zvogëlua deri në 268 sigurues të Jo-Jetës dhe 39 kompani sigurimi të Jetës.



---

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al